



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 437/2024

Datë: 19 / 12 .2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në pajtim me nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 të Ligjit për Noterin dhe nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në përputhje me neni 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjin nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34, 18 Nëntor 2022), si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1.Caktohet Komisioni për pranimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara në Zyrën e Noterit Zyfer (Izet) Aliu në Komunën e Lipjanit dhe dorëzimin e tyre në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega Lipjan, në këtë përbërje:

- 1.1. Arber Shabani, Udhëheqës i Shërbimit Administrativ në Odën e Noterëve, Kryesues;
- 1.2. Teuta Hoxha, Zyrtare e Lartë në Divizionin për Mbikëqyrjen e Noterëve, anëtare;
- 1.3. Emine Bajrami, Arkiviste në Degën Lipjanit, anëtare;

2.Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, mban procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara.

3. Komisioni fillon punën nga dita pasuese e pranimit të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

4.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Noterit, z. Zyfer Aliu;*
- *Odës së Noterëve Kosovës;*
- *Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Lipjan;*
- *Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë ,Profesione të Lira dhe Statistika*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*